

**SEKSIONI 1: Identifikim i lëndës/përgatesës dhe i kompanisë/ndërmarrjes****1.1 Identifikuesi i produktit**

<b>Emri i produktit</b>	Castrol CRB Monograde 10W CF
<b>Kodi i produktit</b>	469523-BE02
<b>SDS (Dëftesë e Sigurisë Teknike) no.</b>	469523
<b>Tipi i produktit</b>	Lëng.

**Përdorimi i lëndës/përgatesës**

Vajrat e Motorit.  
Për këshilla specifike përdorimi, shih Fletën e të Dhënave Teknike ose konsultohuni me përfaqësuesin e shoqërisë sonë.

**1.3 Hollësi për ofruesin e dëftesës së sigurisë teknike**

<b>Furnizuesi</b>	Castrol Holdings Europe B.V., d'Arcyweg 76, 3198NA Europort Rotterdam
	Castrol Hellas MAE 26A, IOANNOU APOSTOLOPOULOU, Chalandri, 15231 Greece +30 210 6887 777
<b>Adresa e postës elektronike (email)</b>	MSDSadvice@bp.com

**1.4 Numri i telefonit për urgjenca**

**NUMRI I TELEFONIT PËR URGJENCA** Carechem: +44 (0) 1235 239 670 (24/7)

**SEKSIONI 2: Identifikimi i rrezikshmërive****2.1 Klasifikimi i lëndës ose i përzjerjes**

**Përkufizimi i produktit** Përzjerje

**Klasifikimi sipas Rregullores (EC) Nr. 1272/2008 [CLP/GHS]**

I paklasifikuar.

Shihni seksionet 11 dhe 12 për informacione më të detajuara rreth ndikimeve në shëndet, simptomave dhe rreziqeve mjedisore.

**2.2 Elemente të etiketës**

<b>Fjalë sinjalizuese</b>	Pa fjalë sinjalizuese.
<b>Njoftime të rrezikshmërisë</b>	Nuk dihet të ketë efekte të rëndësishme ose rreziqe të mëdha.
<b><u>Njoftime paralajmëruese</u></b>	
<b>Parandalim</b>	Nuk zbatohet.
<b>Përgjigje</b>	Nuk zbatohet.
<b>Ruajtja</b>	Nuk zbatohet.
<b>Heqja/Asgjësimi</b>	Nuk zbatohet.
<b>Elemente suplementare të etiketës</b>	Nuk zbatohet.

**Rregullorja BE (EC) Nr. 1907/2006 (REACH)**

**Aneksi XVII – Kufizime në prodhimin, hedhjen në treg dhe përdorimin e disa lëndëve, përzjerjeve dhe artikujve të rrezikshëm** Nuk zbatohet.

**Kërkesa të posaçme për paketimin**

<b>Emri i produktit</b> Castrol CRB Monograde 10W CF	<b>Kodi i produktit</b> 469523-BE02	<b>Faqe:</b> 1/13
<b>Versioni</b> 1	<b>Data e botimit</b> 23 Prill 2024	<b>Formati</b> Shqipëri
		<b>Gjuhe</b> SHQIP
		<b>Shqipëri</b>

**SEKSIONI 2: Identifikimi i rrezikshmërive**

Enët duhen pajisur me kapëse rezistente ndaj fëmijëve	Nuk zbatohet.
Paralajmërim i prekshëm i rrezikut	Nuk zbatohet.

**2.3 Rrezikshmëri të tjera**

<b>Rezultatet e vlerësimit PBT dhe vPvB</b>	Produkti nuk i plotëson kriteret për të qenë PBT ose vPvB sipas shtojcës XIII të Rregullores (KE) nr. 1907/2006.
<b>Produkti plotëson kriteret për PBT ose vPvB sipas shtojcës XIII të Rregullores (KE) Nr. 1907/2006.</b>	Kjo përzierje nuk përmban asnjë substancë që vlerësohet si PBT ose vPvB.
<b>Rrezikshmëri të tjera që nuk figurojnë në klasifikim</b>	Çyndyrues për lëkurën. VAJRAT E PËRDORUR TË MOTORIT Vaji i përdorur i motorit përmban komponentë të rrezikshëm të cilët kanë aftësinë të shkaktojnë kancer në lëkurë. Shikoni Informacione Toksikologjike, pjesa 11 e kësaj Flete të të Dhënave të Sigurisë.

**SEKSIONI 3: Përbërja/të dhëna për ingredientët****3.2 Përzierje**

<b>Përkufizimi i produktit</b>	Përzierje
--------------------------------	-----------

Vaj bazë shumë i rafinuar (ekstrakt IP 346 DMSO <3%) Shtesa adekuate të performancës.

Emri i produktit/ ingredientit	Identifikuesit	%	Klasifikimi	Përq. specifik Limitet, faktorët M dhe ATE-të	Lloji
-----------------------------------	----------------	---	-------------	---	-------

Ky produkt nuk përmban përbërës të rrezikshëm në ose mbi kufijtë e rregulluar.

**SEKSIONI 4: Masa të ndihmës së parë****4.1 Përshkrim i masave të ndihmës së shpejtë**

<b>Kontakt me sytë</b>	Në rast kontakti, shpëlajini sytë menjëherë me ujë të bollshëm për të paktën 15 minuta. Qepallat e syve duhet të mbahen hapur për të garantuar një shpëlarje të plotë. Kontrolloni për lente kontakti dhe hiqini nga sytë sipas rastit. Kërkoni ndihmë mjekësore.
<b>Kontakti me lëkurën</b>	Lajeni mirë lëkurën me ujë dhe sapun, ose përdorni një pastrues lëkure të miratuar. Hiqni rrobat dhe këpucët e ndotura. Lajini rrobat para se t'i ripërdorni. Pastrojini mirë këpucët para se t'i përdorni përsëri. Kërkoni ndihmë mjekësore në rast se shfaqet irritim.
<b>Frymëthithje</b>	Po të frymëthithet, nxirreni personin në ajër të pastër. Kërkoni ndihmë mjekësore në rast se shfaqen simptoma.
<b>Gëlltitje</b>	Mos provokoni të vjellët, me përjashtim të rastit kur këtë jua kërkon personeli mjekësor. Kërkoni ndihmë mjekësore në rast se shfaqen simptoma.
<b>Mbrojtje për personat që japin ndihmën e shpejtë</b>	Nuk duhet ndërmarrë asnjë veprim që shoqërohet me rrezikim të personit ose pa trajnim të përshtatshëm.

**4.2 Simptomat dhe efektet më të rëndësishme, akute dhe të vonuara**

Shihni seksionin 11 për të dhëna më të hollësishme lidhur me pasojat dhe simptomat shëndetësore.

**Efekte shëndetësore akute potenciale**

<b>Frymëthithje</b>	Thithja e avullit në kushte ambienti normalisht nuk është problem për shkak të presionit të ulët të avullit.
<b>Gëlltitje</b>	Nuk dihet të ketë efekte të rëndësishme ose rreziqe të mëdha.
<b>Kontakti me lëkurën</b>	Çyndyrues për lëkurën. Rrezikon të shkaktojë tharje dhe irritim të lëkurës.
<b>Kontakt me sytë</b>	Nuk dihet të ketë efekte të rëndësishme ose rreziqe të mëdha.

**Efekte të menjëhershme dhe të vonuara, si dhe efekte kronike nga ekspozimi afatshkurtër dhe afatgjatë**

<b>Frymëthithje</b>	Ekspozimi i tepërt ndaj thithjes të grimcave në ajër ose aerosoleve mund të shkaktojë irritim në aparatën e frymëmarrjes.
<b>Gëlltitje</b>	Gëlltitja e sasive të mëdha mund të shkaktojë përzierje dhe diarre.
<b>Kontakti me lëkurën</b>	Kontakti i tejkujtur ose i përsëritur mund të dëmtojë lëkurën dhe të çojë në irritim, plasaritje dhe/ose pezmatim të lëkurës.
<b>Kontakt me sytë</b>	Rrezik i mundshëm i thumbimit ose skuqjes kalimtare, në rast se ka kontakt rastësor me sytë.

**4.3 Indikim për kujdesin dhe trajtimin mjekësor të menjëhershëm dhe trajtimin e posaçëm që mund të duhet**

<b>Emri i produktit</b> Castrol CRB Monograde 10W CF	<b>Kodi i produktit</b> 469523-BE02	<b>Faqe:</b> 2/13
<b>Versioni</b> 1	<b>Data e botimit</b> 23 Prill 2024	<b>Formati</b> Shqipëri
		<b>Gjuhe</b> SHQIP
		<b>Shqipëri</b>

**SEKSIONI 4: Masa të ndihmës së parë**

**Shënime për mjekun** Mjekimi duhet të jetë në përgjithësi simptomatik dhe me synimin për të lehtësuar çdo efekt.

**SEKSIONI 5: Masa të luftës kundër zjarrit****5.1 Mjete zjarrfikëse**

**Mjete fikëse të përshtatshme** Në rast zjarri, përdorni fikës me shkumë, lëndë kimike të thatë ose dioksid karboni ose spërkatës.

**Mjete fikëse të papërshtatshme** Mos përdorni rrymë uji. Përdorimi i ujit me presion mund të shkaktojë përhapjen e zjarrit duke spërkatur produktin që po digjet.

**5.2 Rrezikshmëri të posaçme nga lënda ose përzjerja**

**Rrezikshmëritë nga lënda ose përzjerja** Në rast zjarri ose po të nxehet, do të rritet trysnia e brendshme dhe ena mund të plasë.

**Produkte të rrezikshme të djegies** Produktet e djegshme mund të përfshijnë si në vijim: okside karboni (CO, CO<sub>2</sub>)

**5.3 Këshilla për zjarrfikësit**

**Paralajmërimet të posaçme për zjarrfikësit** Nuk duhet ndërmarrë asnjë veprim që shoqërohet me rrezikim të personit ose pa trajnim të përshtatshëm. Izoloheni menjëherë skenën, duke i larguar të gjithë të pranishmit nga vendi i incidentit, në rast se ka rënë zjarr.

**Pajisje mbrojtëse e posaçme për zjarrfikësit** Zjarrfikësit duhet të veshin pajisje mbrojtëse të përshtatshme dhe aparat respirator autonom (SCBA, në anglishte), me maskë të plotë dhe të regjistruar për funksionim në trysni pozitive. Veshjet për zjarrfikësit (duke përfshirë helmetat, çizmet mbrojtëse dhe dorezat) në pajtim me Standardin europian EN 469 do të ofrojnë një nivel bazë mbrojtjeje për incidentet kimike.

**SEKSIONI 6: Masa në rast çlirimi aksidental****6.1 Paralajmërimet personale, pajisje mbrojtëse dhe procedura të urgjencës**

**Për personel jo të ndërhyrjes urgjente** Nuk duhet ndërmarrë asnjë veprim që shoqërohet me rrezikim të personit ose pa trajnim të përshtatshëm. Evakuoni (boshatisni) zonat përreth. Mos lejoni të hyjë personel i panevojshëm dhe i pambrojtur. Mos e prekni materialin e derdhur, as mos ecni nëpër të. Dyshemetë mund të jenë të rrëshqitshme; bëni kujdes për të evituar rrëzimin. Përdorni pajisje të përshtatshme të mbrojtjes personale.

**Për shërbimet e ndërhyrjes urgjente** Në qoftë se kërkohet veshje e specializuar për të trajtuar derdhjen, merrni parasysh çdo informacion në Seksionin 8 për materialet e përshtatshme dhe të papërshtatshme. Shihni edhe informacionin në "Për personel jo të ndërhyrjes urgjente".

**6.2 Masa paraprake për mjedisin**

Shmangni përhapjen e materialit të derdhur, rrjedhjen dhe kontaktin me dheun, vijat ujore, kanalet shkarkuese dhe kanalet e ujërave të zeza. Njoftoni autoritetet përkatëse në rast se produkti ka shkaktuar ndotje të mjedisit (ujërat e zeza, vijat ujore, tokësore ose ajrore).

**6.3 Metoda dhe materiale për kontroll dhe pastrim**

**Derdhje e vogël** Ndaleni rrjedhën pa u rrezikuar. Hiqini enët nga zona ku ka ndodhur derdhja. Përthitheni me një material inert dhe vendoseni në një enë të përshtatshëm për heqje/asgjësim mbetjesh. Eliminoheni nëpërmjet një kontraktori të licencuar për eliminimin e mbetjeve.

**Derdhje e madhe** Ndaleni rrjedhën pa u rrezikuar. Hiqini enët nga zona ku ka ndodhur derdhja. Mos lejoni hyrje në kanale të ujërave të zeza, vija ujore, bodrume të nëndheshme ose zona të mbyllura. Izoloheni dhe grumbullojini derdhjet e vogla me material përthithës të padjegshëm, të tillë si rërë, dhé, vermikulit ose miell fosil, pastaj mblidheni materialin në një enë për heqje/eliminim në pajtim me rregulloret vendore. Eliminoheni nëpërmjet një kontraktori të licencuar për eliminimin e mbetjeve.

**6.4 Referencë në seksione të tjera**

Shihni Seksionin 1 për informacion të kontaktit në rast urgjence.  
Shihni seksionin 5 për masat e zjarrfikësve.  
Shihni Seksionin 8 për informacion në lidhje me pajisjet e përshtatshme të mbrojtjes personale.  
Shihni Seksionin 12 për masa paraprake mjedisore.  
Shihni Seksionin 13 për informacion të mëtejshëm rreth trajtimit të mbetjeve.

**SEKSIONI 7: Trajtimi dhe ruajtja****7.1 Masa paraprake për trajtim të sigurtë****Masa mbrojtëse**

Përdorni pajisje të përshtatshme të mbrojtjes personale.

**Këshilla për higjienën e përgjithshme në vendin e punës**

Në zonën ku trajtohet, ruhet dhe përpunohet ky material, nuk duhet lejuar ngrënia, pirja dhe duhani. Lahuni mirë pasi ta keni trajtuar. Hiqni veshjet dhe pajisjet mbrojtëse të ndotura, para se të futeni në zonat e ngrënies. Shihni edhe Seksionin 8 për informacion të mëtejshëm rreth masave higjienike.

**7.2 Kushtet për ruajtje të sigurt, duke përfshirë edhe papajtueshmëritë e mundshme**

Ruajeni sipas rregulloreve vendore. Ruajeni në një vend të thatë, të freskët e të ajrosur mirë, larg materialeve të papajtueshme (shihni seksionin 10). Mbajeni larg nxehtësisë dhe dritës diellore të drejtpërdrejtë. Mbajeni enën të mbyllur hermetikisht dhe të vulosur derisa të jeni gati për ta përdorur. Enët që janë hapur duhet të mbyllen përsëri hermetikisht me kujdes dhe të mbahen në pozicion vertikal për të parandaluar rrjedhjet. Ruajeni dhe përdoreni vetëm në pajisje/kontejnerë të posaçme për këtë produkt. Mos e ruani në enë të paetiketuar.

**I papërshtatshëm**

Ekspozimi i tejzgatur ndaj temperaturës të lartë

**SEKSIONI 8: Kontrollat e ekspozimit/mbrojtja personale****8.1 Parametra të kontrollit****Kufij të ekspozimit në vendin e punës**

Nuk ka ndonjë vlerë të njohur për kufirin e ekspozimit.

Përderisa kufijtë e caktuar të ekspozimit profesional (KEP) për disa përbërës mund të shfaqen në këtë seksion, ka përbërës të tjerë që mund të jenë të shfaqen në çdo pikëz, avull ose pluhur të krijuar. Prandaj, KEP-të specifike mund të mos zbatohen për produktin në tërësi dhe ofrohen vetëm për udhëzime.

**Procedura monitorizimi të këshilluara**

U duhet referuar standardeve të monitorimit, të tilla si: Standardi Europian EN 689 (Ajri në vendin e punës – Udhëzime për vlerësimin e ekspozimit me frymëthithje ndaj agjentëve kimikë për krahasim me vlerat limit dhe strategjinë e matjeve) Standardi Europian EN 14042 (Ajri në vendin e punës – Udhëzime për zbatimin dhe përdorimin e procedurave për vlerësimin e ekspozimit ndaj agjentëve kimikë dhe biologjikë) Standardi Europian EN 482 (Ajri në vendin e punës – Kërkesa të përgjithshme për ekzekutimin e procedurave për matjen e agjentëve kimikë) Do të jetë i nevojshëm edhe referimi ndaj dokumenteve udhëzuese në rang shtetëror për metodat e përcaktimit të lëndëve me rrezikshmëri.

**Indekset e ekspozimit biologjik****Emri i produktit/ingredientit****Indekset e ekspozimit**

Nuk dihen indekse ekspozimi.

**Niveli i përcaktuar pa ndikim**

Nuk ka DNEL/DMEL.

**PNEC = Koncentrimi i Parashikuar Pa Efekt**

Nuk ka PNEC.

**8.2 Kontrollat e ekspozimit****Komanda inxhinierike të përshtatshme**

Siguroni ventilim shkarkimi ose kontrollat e tjera inxhinierike për të ruajtur përqendrimet përkatëse në ajër nën kufijtë e tyre përkatës të ekspozimit profesional. Të gjitha aktivitetet që përfshijnë kimikate duhet të vlerësohen për rreziqet e tyre ndaj shëndetit, për të siguruar që ekspozimet të kontrollohen në mënyrë të përshtatshme. Pajisjet e mbrojtjes personale duhet të merren në konsideratë vetëm pasi të jenë vlerësuar siç duhet llojet e tjera të masave të kontrollit (p.sh. kontrollat inxhinierike). Pajisjet e mbrojtjes personale duhet të jenë në përputhje me standardet e duhura, të jenë të përshtatshme për përdorim, të mbahen në gjendje të mirë dhe të mirëmbahen siç duhet.

Furnizuesi i pajisjeve të mbrojtjes personale duhet të konsultohet për rekomandimet mbi përzgjedhjen dhe standardet e duhura. Për më shumë informacion, kontaktoni me organizatën kombëtare të standardizimit.

Zgjedhja përfundimtare e pajisjeve mbrojtëse do të varet nga vlerësimi i rrezikut. Është e rëndësishme të siguroheni që të gjitha pajisjet e mbrojtjes personale të jenë të përshtatshme.

**Masa të mbrojtjes individuale****Masa higjienike**

Pasi të keni punuar me produkte kimike, lajini duart, parakrahët dhe fytyrën mirë e me kujdes, para se të hani, të pini duhan, të përdorni shërbimet higjienike dhe në përfundim të orarit të punës. Sigurohuni që pikat e posaçme për larje sysh dhe dushet e sigurimit janë në afërsi të vendit të punës.

**Mbrojtje për frymëmarrjen**

## SEKSIONI 8: Kontrollat e ekspozimit/mbrojtja personale

Në rast ajrimi të pamjaftueshëm, përdorni pajisje respiratore të përshtatshme. Zgjedhja e duhur e mbrojtjes respiratore varet në lëndët kimike që po përdoren, kushtet e punës dhe të përdorimit dhe gjendja e pajisjeve respiratore. Duhet të zhvillohen procedurat e sigurisë për çdo aplikim të menduar. Prandaj pajisjet mbrojtëse respiratore duhet të zgjidhen duke u konsultuar me furnitorin / prodhuesin dhe me një përlogaritje të plotë të kushteve të punës.

[Mbrojtje për sytë/fytyrën](#)

[Mbrojtje për lëkurën](#)

[Mbrojtje për duart](#)

Syze mbrojtëse sigurie me mburoja anësore.

### Të dhëna të përgjithshme

Për shkak se mjediset e caktuara të punës dhe praktikat e trajtimit të materialeve ndryshojnë, duhet të zhvillohen procedurat e sigurisë për çdo aplikim të menduar. Zgjedhja e duhur e dorezave mbrojtëse varet nga lëndët kimike që po trajtohen dhe kushtet e punës dhe përdorimit. Shumica e dorezave sigurojnë mbrojtje vetëm për një kohë të kufizuar dhe prandaj duhet të hidhen dhe të ndërrohen (edhe dorezat më rezistente ndaj lëndëve kimike do të prishen pas ekspozimeve të përsëritura ndaj lëndëve kimike).

Dorezat duhet të zgjidhen duke u konsultuar me furnitorin / prodhuesin dhe duke marrë parasysh llogaritjen e plotë të kushteve të punës.

Rekomanduar: Doreza nitrili.

Të dhënat e kohës së depërtimit janë nxjerrë nga prodhuesit e dorezave nën kushtet e testeve laboratorike dhe tregojnë sa gjatë mund të pritët që një dorezë të sigurojë rezistencë të efektshme depërtimi. Gjatë zbatimit të rekomandimeve të kohës të depërtimit është e rëndësishme që të merren parasysh kushtet aktuale të vendit të punës. Gjithmonë konsultohuni me furnitorin e dorezave për informacione teknike të përditësuara për kohët e depërtimit për llojin e rekomanduar të dorezave.

Rekomandimet tona për zgjedhjen e dorezave janë si më poshtë:

Kontakt i vazhdueshëm:

Doreza me një kohë minimale depërtimi prej 240 minutash, ose >480 minuta nëse përdoren dorezat e përshtatshme.

Nëse nuk ndodhen dorezat e përshtatshme që ofrojnë atë nivel mbrojtjeje, dorezat me kohë më të shkurtër depërtimi mund të jenë të pranueshme për sa kohë përcaktohen dhe përmblen mirëmbajtjet e duhur atë dorezave dhe regjimet e ndërrimit.

Mbrojtja ndaj spërkatjeve / afat-shkurtër:

Kohët e rekomanduara të depërtimit si më sipër.

Dihet se për ekspozimet afatshkurtra, të rastësishme mund të përdoren zakonisht doreza me kohë më të shkurtra depërtimi. Prandaj, duhet të përcaktohet mirëmbajtja e duhur dhe regjimet e ndërrimit dhe të zbatohen me rreptësi.

### Trashësia e dorezave:

Për përdorime të përgjithshme, ne zakonisht rekomandojmë doreza me trashësi më të madhe se 0,35 mm.

Duhet të theksohet se trashësia e dorezave nuk është domosdoshmërisht një tregues i mirë i rezistencës së tyre ndaj një kimikati specifik, pasi efikasiteti i depërtimit në dorezë do të varet nga përbërja e duhur e materialit të dorezës. Prandaj, përzgjedhja e dorezave duhet të bazohet gjithashtu në shqyrtimin e kërkesave të punëve dhe njohurive të kohës.

Trashësia e dorezave mund të ndryshojë gjithashtu në varësi të prodhuesit të dorezave, llojit të dorezave dhe modelit të tyre. Prandaj, duhet të merren gjithmonë parasysh të dhënat teknike të prodhuesit për të siguruar zgjedhjen e dorezave më të përshtatshme për punën.

Shënim: Në varësi të veprimtarisë së kryer, mund të nevojiten doreza me trashësi të ndryshme për punë specifike. Për shembull:

- Dorezat më të holla (deri në 0,1 mm ose më pak) mund të kërkohen kur nevojitet shkathtësi e lartë e duarve. Megjithatë, ka gjasa që këto doreza të sigurojnë vetëm mbrojtje afatshkurtër dhe normalisht do të vlenin vetëm për një përdorim dhe më pas do të hidheshin.

**SEKSIONI 8: Kontrollat e ekspozimit/mbrojtja personale**

• Mund të nevojiten doreza më të trasha (deri në 3 mm ose më shumë) kur ka rrezik mekanik (si dhe kimik), d.m.th. aty ku ka potencial gërryerje ose shpimi.

**Lëkurë dhe trup**

Përdorimi i veshjeve mbrojtëse është një praktikë e mirë industriale. Pajisjet e mbrojtjes personale për trupin duhen përzgjedhur në bazë të detyrës që duhet kryer dhe rreziqeve përkatëse, si dhe miratuar nga një specialist para se të trajtohet ky produkt. Pambuku ose veshjet prej polisetri/pambuku do të sigurojnë mbrojtje vetëm kundrejt ndotjeve të lehta sipërfaqësore të cilat nuk do të depërtojnë në lëkurë. Veshjet duhet të lahen rregullisht. Kur ekspozimi ndaj lëkurës është i lartë (p.sh. kur pastroni spërkatjet ose ekziston rreziku i spërkatjes) atëherë kërkohen përparëse rezistente ndaj lëndëve kimike dhe/ose kostume e çizme të padepërtueshme nga lëndët kimike.

**Referojuni standardeve:**

Mbrojtje për frymëmarrjen: EN 529  
Doreza: EN 420, EN 374  
Mbrojtje për sytë: EN 166  
Gjysmë-maskë filtruese: EN 149  
Gjysmë-maskë filtruese me valvulë: EN 405  
Gjysmë-maskë: EN 140 plus filtër  
maskë e plotë: EN 136 plus filtër  
Filtër grimcash: EN 143  
Filtër gazi/të kombinuara: EN 14387

**Kontrolle të ekspozimit mjedisor**

Prurjet e sistemit të ajrimit ose e pajisjeve të procesit të punës duhen kontrolluar për t'u siguruar se u përmbahen kërkesave të ligjshmërisë për mbrojtjen e mjedisit. Në disa raste do të jetë e nevojshme të përdoren skruber tymrash, filtra ose modifikime inxhinierike të pajisjeve përpunuese, për t'i reduktuar emisionet deri në nivele të pranueshme.

**SEKSIONI 9: Vetitë fizike dhe kimike****9.1 Informacion për vetitë fizike dhe kimike themelore****Pamja**

Gjendja fizike

Lëng.

Ngjyra

Qelibar. [I lehtë]

Kundërmimi

Nuk zotërohet.

Pragu i kundërmimit

Nuk zotërohet.

pH

Nuk zbatohet.

Pika e shkrirjes/pika e ngrirjes

Nuk zotërohet.

Pika fillestare e vlimit dhe intervali i vlimit

Nuk zotërohet.

Pika e derdhjes

-42 °C

Pika e flakërimit

Kupë e mbyllur: 210.5°C (410.9°F) [Pensky-Martens]

Shpejtësia e avullimit

Nuk zotërohet.

Ndezshmëria (lëndë e ngurtë ose gaz)

Nuk zotërohet.

Limiti plasës i poshtëm dhe sipërm

Nuk zotërohet.

Presioni i avullit

Emri i përbërësit	Presioni i avullit në 20°C		Presioni i avullit në 50°C	
	mm Hg	kPa	Metoda	mm Hg kPa
Distilata (naftë), parafinë e rëndë e trajtuar me hidrogjen	<0.07501	<0.01	ASTM D 5191	
Benzenesulfonic acid, C14-44-branched and linear alkyl derivs., calcium salts, overbased	0.000032	0.0000043	EU A.4	

Dendësia e avullit

Nuk zotërohet.

Denduria relative

Nuk zotërohet.

Dendësia

<1000 kg/m<sup>3</sup> (<1 g/cm<sup>3</sup>) at 15°C

Tretshmëria/të

**SEKSIONI 9: Vetitë fizike dhe kimike**

Mjete	Rezultati
ujë	Nuk tretet

<b>Koeficienti i përndarjes oktanol/ujë</b>	Nuk zbatohet.
<b>Temperatura e vetëndezjes</b>	Nuk zotërohet.
<b>Temperatura e shpërbërjes</b>	Nuk zotërohet.
<b>Viskoziteti (ngjitshmëri)</b>	Kinematike: 41.76 mm <sup>2</sup> /s (41.76 cSt) at 40°C Kinematike: 6.7 mm <sup>2</sup> /s (6.7 cSt) at 100°C
<b>Vetitë shpërthyesë</b>	Nuk zotërohet.
<b>Veti oksiduese</b>	Nuk zotërohet.

**9.2 Të dhëna të tjera**

S'ka të dhëna të mëtejshme.

**SEKSIONI 10: Qëndrueshmëria dhe reaktiviteti**

<b>10.1 Reaktiviteti</b>	Nuk ka të dhëna specifike për testimin e këtij produkti. Për informacion shtesë, shihni kushtet që duhen shmangur dhe materialet e papajtueshme.
<b>10.2 Qëndrueshmëria kimike</b>	Produkti është i qëndrueshëm.
<b>10.3 Mundësi reaksionesh të rrezikshme</b>	Në kushte normale të ruajtjes dhe përdorimit nuk do të ndodhin reaksione të rrezikshme. Në kushte normale të ruajtjes dhe të përdorimit, nuk do të ndodhë ndonjë polimerizim i rrezikshëm.
<b>10.4 Rrethana për t'u shmangur</b>	Shmangni të gjitha burimet e mundshme të ndezjes (shkëndijë ose flakë).
<b>10.5 Materiale të papajtueshme</b>	Reaktiv ose i papajtueshëm me materialet e mëposhtme: materiale oksiduese.
<b>10.6 Produkte të rrezikshme të shpërbërjes</b>	Në kushte normale ruajtjeje dhe përdorimi, nuk duhet të përftohen produkte të rrezikshme të shpërbërjes.

**SEKSIONI 11: Të dhëna toksikologjike****11.1 Informacioni për kategoritë e rreziqeve sipas përcaktimit në rregulloren (BE) nr. 1272/2008**Vlerësime paraprake të toksicitetit akut

Nuk zotërohet.

**Të dhëna për rrugët e mundshme të ekspozimit** Rrugëhyrje të parashikuara: Dermal, Frymëthithje, Sy.

Efekte shëndetësore akute potenciale

<b>Frymëthithje</b>	Thithja e avullit në kushte ambienti normalisht nuk është problem për shkak të presionit të ulët të avullit.
<b>Gëlltitje</b>	Nuk dihet të ketë efekte të rëndësishme ose rreziqe të mëdha.
<b>Kontakti me lëkurën</b>	Çyndyrues për lëkurën. Rrezikon të shkaktojë tharje dhe irrim të lëkurës.
<b>Kontakt me sytë</b>	Nuk dihet të ketë efekte të rëndësishme ose rreziqe të mëdha.

Simptoma që kanë lidhje me karakteristikat fizike, kimike dhe toksikologjike

<b>Frymëthithje</b>	Nuk ka të dhëna specifike.
<b>Gëlltitje</b>	Nuk ka të dhëna specifike.
<b>Kontakti me lëkurën</b>	Simptomat e padëshirueshme mund të përfshijnë sa vijon: irrim tharje plasaritje
<b>Kontakt me sytë</b>	Nuk ka të dhëna specifike.

Efekte të menjëhershme dhe të vonuara, si dhe efekte kronike nga ekspozimi afatshkurtër dhe afatgjatë

<b>Frymëthithje</b>	Ekspozimi i tepërt ndaj thithjes të grimcave në ajër ose aerosoleve mund të shkaktojë irrim në aparatit e frymëmarrjes.
<b>Gëlltitje</b>	Gëlltitja e sasive të mëdha mund të shkaktojë përzierje dhe diarre.

**SEKSIONI 11: Të dhëna toksikologjike**

<b>Kontakti me lëkurën</b>	Kontakti i tejzgjatur ose i përsëritur mund të dëmtojë lëkurën dhe të çojë në irrim, plasaritje dhe/ose pezmatim të lëkurës.
<b>Kontakt me sytë</b>	Rrezik i mundshëm i thumbimit ose skuqjes kalimtare, në rast se ka kontakt rastësor me sytë.
<b>Efekte shëndetësore kronike potenciale</b>	
<b>Të përgjithshme</b>	VAJRAT E PËRDORUR TË MOTORËVE Produktet e djegies që vijnë nga operimi i motorëve me djegie të brendshme ndotim vajrat e motorit gjatë përdorimit. Vaji i përdorur i motorit përmban komponentë të rrezikshëm të cilët kanë aftësinë të shkaktojnë kancer në lëkurë. Kontakti i shpeshtë ose i tejzgjatur me të gjithë llojet dhe prodhimet e vajit të përdorur të motorit duhet shmangur dhe të ruhen standardet e larta të higjienës personale.
<b>Karcinogjeniciteti</b>	Nuk dihet të ketë efekte të rëndësishme ose rreziqe të mëdha.
<b>Mutagjeniciteti</b>	Nuk dihet të ketë efekte të rëndësishme ose rreziqe të mëdha.
<b>Efekte zhvillimore</b>	Nuk dihet të ketë efekte të rëndësishme ose rreziqe të mëdha.
<b>Efekte ndaj pjellshmërisë</b>	Nuk dihet të ketë efekte të rëndësishme ose rreziqe të mëdha.

**11.2 Informacion për rreziqe të tjera****11.2.1 Tiparet çrregulluese endokrine**

Nuk zotërohet.

**Remarks - Endocrine** Nuk zotërohet.**disrupting properties for human health Summary/ Conclusion (All ingredients)****11.2.2 Të dhëna të tjera**

Nuk zotërohet.

**SEKSIONI 12: Të dhëna ekologjike****12.1 Toksiciteti****Rrezikshmëri mjedisore** Nuk klasifikohet si i rrezikshëm**12.2 Qëndrueshmëria dhe degradueshmëria**

Pritet të jetë i biodegradueshëm.

**12.3 Potenciali biogrumbullues**

Ky produkt nuk pritet të bioakumulohet nëpërmjet vargut të ushqimit në mjedis.

**12.4 Lëvizshmëria në dhé****Koeficient i përndarjes dhé/ ujë (K<sub>oc</sub>)** Nuk zotërohet.**Lëvizshmëria** Mbetjet mund të depërtojnë në tokë duke shkaktuar ndotje të ujërave nëntokësore.**12.5 Rezultatet e vlerësimit PBT dhe vPvB**

Produkti nuk i plotëson kriteret për të qenë PBT ose vPvB sipas shtojcës XIII të Rregullores (KE) nr. 1907/2006.

**12.6 Efekte të tjera të padëshirueshme****Tiparet çrregulluese endokrine** Nuk zotërohet.**Remarks - Endocrine** Nuk zotërohet.**disrupting properties for environment Summary/ Conclusion (All ingredients)****Të dhëna të tjera ekologjike** Spërkatjet mund të formojnë një shtresë mbi sipërfaqet e ujit duke shkaktuar dëmtime fizike për organizmat. Mund të dëmtohet gjithashtu transferimi i oksigjenit.



**SEKSIONI 13: Konsiderata për eliminimin****13.1 Metoda të trajtimit të mbetjeve****Produkti****Metoda të eliminimit**

Aty ku është e mundur, sigurohuni që produkti të riciklohet. Hedhje me anë të një personi të autorizuar/ kontraktor i licencuar për hedhjen e mbeturinave sipas rregullave vendase.

**Mbetje e rrezikshme**

Me sa është në dijeni furnizuesi, ky produkt nuk konsiderohet si mbetje e rrezikshme, në bazë të Direktivës EU 2008/98/EC.

**Ambalazhimi****Metoda të eliminimit**

Aty ku është e mundur, sigurohuni që produkti të riciklohet. Hedhje me anë të një personi të autorizuar/ kontraktor i licencuar për hedhjen e mbeturinave sipas rregullave vendase.

**Masa mbrojtëse të posaçme**

Ky material dhe ena përkatëse duhen eliminuar në mënyrë të sigurt. Kontejnerët e zbratur ose guarnicionet mund të kenë ruajtur ndonjë mbeturinë të produktit. Shmangni përhapjen e materialit të derdhur, rrjedhjen dhe kontaktin me dheun, vijat ujore, kanalet shkarkuese dhe kanalet e ujërave të zeza.

**Referenca**

Komisioni 2014/955/BE  
Direktiva 2008/98/KE

**SEKSIONI 14: Të dhëna për transportin**

	ADR/RID	ADN	IMDG	IATA
14.1 Numri i OKB-së ose numri ID	I parregulluar.	I parregulluar.	I parregulluar.	I parregulluar.
14.2 Emri i përshtatshëm për transportim KB (UN)	-	-	-	-
14.3 Klasa(t) e rrezikshmërisë për transport	-	-	-	-
14.4 Grupi i ambalazhimit	-	-	-	-
14.5 Rrezikshmëri mjedisore	Jo.	Jo.	Jo.	Jo.
Të dhëna të mëtejshme	-	-	-	-

**14.6 Masa parambrojtëse të posaçme për përdoruesin**

Nuk zotërohet.

**14.7 Transporti detar rifuxho sipas instrumenteve IMO**

Nuk zotërohet.

**SEKSIONI 15: Të dhëna rregullatore****15.1 Rregulloret/legjislati i sigurisë, shëndetit dhe mjedisit i posaçëm për lëndën ose përzierjen****Rregullorja BE (EC) Nr. 1907/2006 (REACH)****Aneksi XIV – Lista e lëndëve që kërkojnë autorizim****Aneksi XIV**

Asnjë nga përbërësit nuk është i listuar.

**Lëndë jashtëzakonisht shqetësuese**

Asnjë nga përbërësit nuk është i listuar.

**Aneksi XVII – Kufizime në prodhimin, hedhjen në treg dhe përdorimin e disa lëndëve, përzierjeve dhe artikujve të rrezikshëm**

Emri i produktit/ingredientit	%	Përcaktimi [Përdorimi]
toluene	≤0.1	48
benzene	<0.1	5
		72

**Etiketimi**

Nuk zbatohet.

Emri i produktit Castrol CRB Monograde 10W CF

Kodi i produktit 469523-BE02

Faqe: 9/13

Versioni 1

Data e botimit 23 Prill 2024

Formati Shqipëri  
Shqipëri

Gjuhe SHQIP

## SEKSIONI 15: Të dhëna rregullatore

### Rregullore të tjera

**Statusi REACH (Regjistrimi, Vlerësimi, Autorizimi dhe Kufizimi i Kimikateve)** Shoqëria, e identifikuar në seksionin 1, e shet këtë produkt në BE në përputhje me kërkesat aktuale të REACH.

**Inventari Shtetet e Bashkuara (TSCA, Ligji Amerikan i Kontrollit të Lëndëve Toksike, 8b)** Të gjithë elementët përbërës janë aktivë ose të përjashtuar.

**Inventari Australia (AIC)** Të gjithë përbërësit janë të listuar ose të përjashtuar.

**Inventari Kanada** Të gjithë përbërësit janë të listuar ose të përjashtuar.

**Inventari Kinë (IECSC)** Të gjithë përbërësit janë të listuar ose të përjashtuar.

**Inventari Japoni (CSCL)** Të gjithë përbërësit janë të listuar ose të përjashtuar.

**Inventari Kore (KECI)** Të gjithë përbërësit janë të listuar ose të përjashtuar.

**Inventari Filipine (PICCS)** Të gjithë përbërësit janë të listuar ose të përjashtuar.

**Inventari Tajvani (TCSI)** Të gjithë përbërësit janë të listuar ose të përjashtuar.

**Explosive precursors** Nuk zbatohet.

### Substanca që shkatërrojnë ozonin (1005/2009/EU)

I palistuar.

### Pëlqim i informuar paraprak (PIC) (649/2012/EU)

I palistuar.

### Direktiva Seveso

Ky produkt nuk kontrollohet nga Direktiva Seveso.

**15.2 Vlerësimi i Sigurisë Kimike** Është kryer një Vlerësim i Sigurisë Kimike për një ose më shumë substanca brenda kësaj përzierjeje. Nuk është kryer ndonjë Vlerësim i Sigurisë Kimike për vetë përzierjen.

## SEKSIONI 16: Të dhëna të tjera

### Shkurtime dhe akronime

ADN = Dispozita Evropiane lidhur me Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme me Vija Ujore të Brendshme  
 ADR = Marrëveshja Evropiane lidhur me Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme me Vija Rrugore  
 ATE = Vlerësimi paraprak i Toksicitetit Akut  
 BCF = Faktori Biokoncentrimi  
 CAS = Shërbimi i Abstrakteve Kimike  
 CLP = Rregullore Klasifikimi, Etiketimi dhe Ambalazhimi [Rregullore (EC) Nr. 1272/2008]  
 CSA = Vlerësimi i Sigurisë Kimike  
 CSR = Raporti i Sigurisë Kimike  
 DMEL = Niveli i Efektit Minimal të Derivuar  
 DNEL = Niveli i Derivuar Pa Efekt  
 EINECS = Inventari Evropian i Lëndëve Kimike Komerciale Ekzistuese  
 ES = Skenarët e Ekspozimit  
 Njoftimi EUH = njoftimi i Rrezikshmërisë specifik për CLP  
 EWC = Katalogu Evropian i Mbetjeve  
 GHS = Sistemi i Harmonizuar Botërisht për Klasifikimin dhe Etiketimin e Kimikateve  
 IATA = Shoqata e Transportit Ajror Ndërkombëtar  
 IBC = Enë Mbajtëse (kontejner) për Shumica të Ndërmjetme  
 IMDG = Mallra të Rrezikshme Detare Ndërkombëtare  
 LogPow = logaritëm i koeficientit të përndarjes oktanoli/uj  
 MARPOL = Konventa Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjes Nga Anijet, 1973 si e modifikuar nga Protokoli of 1978. ("Marpol" = ndotje detare)  
 OECD = Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik e Zhvillimin  
 PBT = Vazhdueshëm, Biogrumbullues dhe Toksik  
 PNEC = Koncentrimi i Parashikuar Pa Efekt  
 REACH = Rregullore Regjistrimi, Vlerësimi, Autorizimi dhe Kufizimi i Kimikateve Rregullore (EC) Nr. 1907/2006]  
 RID = Rregulloret lidhur me Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme me Vija Hekurudhore  
 RRN = Numër Regjistrimi REACH  
 SADT = Temperatura e Shpërbërjes Vet-Përshpejtuese  
 SVHC = Lëndë me Shqetësim Shumë të Lartë  
 STOT-RE = Toksiciteti Specifik për Organin e Shënjestruar (Ekspozim i Përsëritur)  
 STOT-SE = Toksiciteti Specifik për Organin e Shënjestruar (Një Ekspozim i Vetëm)  
 TWA (Mesatare Kohë-Peshë) = Mesatarja e ponderuar e kohës  
 UN = Kombet e Bashkuara

**Emri i produktit** Castrol CRB Monograde 10W CF

**Kodi i produktit** 469523-BE02

**Faqe:** 10/13

**Versioni** 1

**Data e botimit** 23 Prill 2024

**Formati** Shqipëri  
Shqipëri

**Gjuhe** SHQIP

**SEKSIONI 16: Të dhëna të tjera**

UVCB = Substancë komplekse hidrokarbure  
 VOC = Komponenti Organik i Pastabilizuar  
 vPvB = Shumë i Vazhdueshëm dhe Shumë Biogrubullues  
 Ndryshon = mund të përmbajë një ose më shumë nga të mëposhtmet 64741-88-4 / RRN 01-2119488706-23, 64741-89-5 / RRN 01-2119487067-30, 64741-95-3 / RRN 01-2119487081-40, 64741-96-4 / RRN 01-2119483621-38, 64742-01-4 / RRN 01-2119488707-21, 64742-44-5 / RRN 01-2119985177-24, 64742-45-6, 64742-52-5 / RRN 01-2119467170-45, 64742-53-6 / RRN 01-2119480375-34, 64742-54-7 / RRN 01-2119484627-25, 64742-55-8 / RRN 01-2119487077-29, 64742-56-9 / RRN 01-2119480132-48, 64742-57-0 / RRN 01-2119489287-22, 64742-58-1, 64742-62-7 / RRN 01-2119480472-38, 64742-63-8, 64742-65-0 / RRN 01-2119471299-27, 64742-70-7 / RRN 01-2119487080-42, 72623-85-9 / RRN 01-2119555262-43, 72623-86-0 / RRN 01-2119474878-16, 72623-87-1 / RRN 01-2119474889-13

**Procedura e përdorur për të derivuar klasifikimin sipas Rregullores (EC) No. 1272/2008 [CLP/GHS]**

Klasifikimi	Justifikimi
I paklasifikuar.	

**Teksti i plotë i klasifikimeve [CLP/GHS]**

Nuk zbatohet.

**Evropë****Teksti i plotë i deklaratave** Nuk zbatohet.**H të shkurtuara****Teksti i plotë i klasifikimeve** Nuk zbatohet.**[CLP/GHS]****Historia****Data e botimit/ Data e ndryshimit** 23/04/2024.**Data e botimit të mëparshëm****Përgatitur nga** Product Stewardship Group**Tregon të dhëna që kanë ndryshuar në krahasim me versionin e botuar më parë.****Njoftim për lexuesin**

Janë ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm për të siguruar që kjo fletë të dhënash dhe informacioni për shëndetin, sigurinë dhe mjedisin që ajo përmban të jenë të sakta që prej datës së përcaktuar më poshtë. Nuk ka asnjë garanci ose përfaqësim, qoftë të shprehur apo të nënkuptuar, në lidhje me saktësinë ose plotësinë e të dhënave dhe informacionit që gjendet në këtë fletë të dhënash.

Të dhënat dhe sugjerimet e dhëna vlejné kur produkti shitet për përdorimin ose përdorimet e përcaktuara. Përveçse për përdorimin ose përdorimet e përcaktuara, produkti nuk duhet të përdoret pa kërkuar më parë sugjerime nga BP Group.

Është detyrimi i përdoruesit që të vlerësojë dhe të përdorë këtë produkt në mënyrë të sigurt dhe në përputhje me të gjithë legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme. Përveç përdorimit të përcaktuar, BP Group nuk mban përgjegjësi për asnjë dëmtim ose lëndim të shkaktuar nga përdorimi si pasojë e mosrespektimit të rekomandimeve ose nga ndonjë rrezik i qenësishëm i llojit të materialit. Blerësit e produktit për furnizim të një pale të tretë e cila do ta përdorë në punë, kanë për detyrë që të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar që çdo person që merret ose përdor produktin të ketë marrë informacionin që ndodhet në këtë fletë. Punëdhënësit kanë për detyrë t'u tregojnë punonjësve dhe të tjerëve që mund të preken nga rreziqet e përshkruara në këtë fletë dhe për çdo masë paraprake që duhet të merret. Ju mund të kontaktoni BP Group për t'u siguruar që ky dokument të jetë më i përditësuar. Ndalohet rreptësisht ndryshimi i këtij dokumenti.

**SEKSIONI 16: Të dhëna të tjera**

**Emri i produktit** Castrol CRB Monograde 10W CF

**Kodi i produktit** 469523-BE02

**Faqe:** 12/13

**Versioni** 1

**Data e botimit** 23 Prill 2024

**Formati** Shqipëri  
Shqipëri

**Gjuhe** SHQIP

**SEKSIONI 16: Të dhëna të tjera**

